



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.43

27 prill

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 39/2012 datë 12.4.2012	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të OPEC-ut për Zhvillim Ndërkombëtar për financimin e projektit të rrugës Tiranë-Elbasan.....	2303
Ligj nr. 40/2012 datë 12.4.2012	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin shtesë të projektit “Siguria e digave”.....	2319
Ligj nr. 41/2012 datë 12.4.2012	Për afatet dhe procedurat e mbylljes së procesit të kontrollit financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë.....	2328

LIGJ
Nr. 39/2012

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE FONDIT TË OPEC-UT PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR PËR
FINANCIMIN E PROJEKTIT TË RRUGËS TIRANË-ELBASAN**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të OPEC-ut për Zhvillim Ndërkombëtar për financimin e projektit të rrugës Tiranë-Elbasan.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 12.4.2012

Shpallur me dekretin nr. 7410 datë 23.4.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

DRAFT PROJEKTI I RRUGËS TIRANË-ELBASAN
MARRËVESHJE HUAJE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE FONDIT OPEC PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR
DATË _____, 2011

Marrëveshje e datës _____, 2011, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi) dhe OFID,

duke pasur parasysh se Huamarrësi ka kërkuar një hua nga OFID për financimin e pjeshëm të Projektit të përshkruar në skedulën 1;

dhe duke pasur parasysh se OFID ka aprovuar një hua për huamarrësin në shumën e njëzet milionë e katërqind mijë dollarëve (\$ 20, 400,000) sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara më poshtë;

për pasojë, palët e kësaj marrëveshjeje huaje (marrëveshja) në këtë mënyrë bien dakord si më poshtë,



Neni 1

Kushtet e përgjithshme; përkufizimet

1.01 Kushtet e përgjithshme të bashkëlidhura këtij dokumenti përbëjnë pjesë integrale të kësaj marrëveshjeje.

1.02 Përveç kushteve të përcaktuara në preambul, kushtet dhe shprehjet e mëposhtme mbartin kuptimet e mëposhtme ose kur zëvendësojnë kushtet dhe shprehjet në kushtet e përgjithshme, mbartin kuptimet e mëposhtme specifike:

- a) “Përfaqësues i autorizuar i huamarrësit” nënkupton ministrin e financave të huamarrësit;
- b) “Datë e mbylljes” nënkupton datën 15 korrik 2015;
- c) “Dollar dhe shenja “\$”” nënkuptojnë dhe i referohen monedhës së ligjshme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës;
- d) “Datë e fillimit të shpenzimeve të pranueshme” nënkupton datën 16 qershor 2011;
- e) “Agjenci zbatuese” nënkupton autoritetin rrugor shqiptar të huamarrësit;
- f) “Kushtet e përgjithshme” nënkuptojnë kushtet e përgjithshme të OFID, të zbatueshme për marrëveshjet e huas për sektorin publik, janar 2007;
- g) “Periudhë pa interes” nënkupton periudhën që fillon më [data e marrëveshjes] dhe që përfundon pesë (5) vjet pas asaj date; dhe
- h) “Administrator i huas” nënkupton Bankën Islamike për Zhvillim.

Neni 2

Huaja

2.01 OFID bie dakord t’i japë hua huamarrësit dhe huamarrësi bie dakord të marrë hua nga OFID, huanë në shumën e njëzet milionë e katërqind mijë dollarëve (\$ 20,400,000) sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje.

2.02 Huamarrësi shlyen interesin në normën e tre e tre të dhjetave të njëpërqindshit (3.3%) në vit të shumës së principalit të huas së tërhequr dhe të papaguar.

2.03 Huamarrësi paguan një detyrim shërbimi vjetor në normën e njëpërqindshit (1%) të shumës së principalit të huas së tërhequr dhe të papaguar.

2.04 Interesi dhe detyrimet e shërbimit paguhet çdo gjashtë muaj më 15 gusht dhe 15 shkurt të çdo viti në llogarinë e OFID-it.

2.05 Menjëherë pas përfundimit të periudhës pa interes, huamarrësi shlyen principalin e huas në dollarë ose në çdo monedhë tjetër lirisht të konvertueshme dhe të pranueshme për menaxhimin e OFID-it, në një shumë të barasvlershme me shumën në dollarë për t’u paguar sipas kursit ekzistues të këmbimit të tregut në kohën dhe vendin e shlyerjes. Shlyerja do të realizohet në tridhjetë (30) këste gjashtëmujore në shumat dhe në datat ku të gjitha specifikohen në skedulën 3 (amortizimi).

Neni 3

Hyrja në fuqi

3.01 Kjo marrëveshje hyn në fuqi dhe efekt në përputhje me seksionin 3.02, pas marrjes nga OFID:

a) të të dhënave të mjaftueshme se ekzekutimi dhe përmbushja e kësaj marrëveshjeje në emër të huamarrësit të jetë autorizuar dhe ratifikuar sipas rregullave, në përputhje me kërkesat kushtetuese të huamarrësit;

b) të një vërtetimi të lëshuar nga ministri i drejtësisë ose prokurori i përgjithshëm apo çdo autoritet tjetër kompetent ligjor i huamarrësit që konfirmon se kjo marrëveshje është autorizuar dhe

ratifikuar sipas rregullave nga ana e huamarrësit dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe detyruet për huamarrësin në përputhje me kushtet e saj; dhe

c) të të dhënave se huaja ose marrëveshja tjetër financiare ndërmjet administratorit të huas dhe huamarrësit për financimin e projektit është shpallur në fuqi ose do të shpallet në fuqi njëkohësisht me këtë marrëveshje.

3.02 Sa më shpejt që të jetë e mundur, pasi kushtet e përcaktuara në seksionin 3.01 të jenë plotësuar në mënyrë të mjaftueshme, kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi dhe efekt të plotë në datën e hyrjes në fuqi.

3.03 Nëse kjo marrëveshje nuk hyn në fuqi brenda nëntëdhjetë (90) ditëve pas datës së marrëveshjes, marrëveshja dhe të gjitha detyrimet e palëve sipas saj përfundojnë, nëse menaxhimi i OFID-it, pasi të ketë marrë në konsideratë shkaqet e vonesës, përcakton një datë më të vonshme për qëllime të këtij seksioni.

Neni 4 Adresat

4.01 Adresat e palëve specifikohen më poshtë:

Për huamarrësin:

Ministria e Financave

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”

Nr. 1, 1001

Tiranë

Republika e Shqipërisë

Faks: (+ +355-4) 229200

Për OFID:

Fondi OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar:

Parkring 8

A-1010 Vienna

AUSTRI

Faks: (+ +43-1) 513 92 38

HUA NR. _____ P

Në dëshmi sa më sipër, palët e kësaj marrëveshjeje, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar sipas rregullave, kanë realizuar nënshkrimin dhe përmbushjen e kësaj marrëveshjeje në Vienë në dy kopje, në gjuhën angleze, secila e konsideruar si origjinale dhe të dyja me qëllimin e njëjtë dhe të vetëm sipas datës dhe vitit të shkruar më sipër.

Për huamarrësin:

Nënshkrimi:

Emri: _____

Pozicioni: _____

Për Fondin OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar

Nënshkrimi:

Emri: Suleiman J. Al-Herbish

Pozicioni: Drejtor i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROJEKTI I RRUGËS TIRANË-ELBASAN

SKEDULI 1
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Projekti ka për qëllim të nxisë integrimin e tregtisë rajonale dhe ndërkombëtare të Shqipërisë me anë të ndërtimit të një rruge ndërmjet kryeqytetit, Tiranë dhe qytetit të Elbasanit. Objektivat e projektit do të arrihen nëpërmjet zbatimit të komponentëve të mëposhtëm:

a) Punime civile: përbëhen nga ndërtimi i 27 km rrugë të asfaltuar me dy korsi në secilin drejtim. Rruga do të ketë katër korsi për trafikun dhe dy korsi emergjence. Punimet gjithashtu do të përfshijnë përgatitjen e kantierit, punime tokësore, si dhe instalimin e sistemeve të drenazhimit, mbrojtjen nga pjerrësitë, pajisjet e sigurisë së trafikut dhe ndërtimin e urave, rrugëve anësore, ndarjet e mesit dhe viaduktet. Punimet do të ndahen në tre sektorë:

a. 1. Sektori 1 do të mbulojë punimet që lidhen me pjesën e rrugës nga qyteti i Tiranës deri në portalin e tunelit (13 km);

a. 2. Sektori 2 do të përfshijë punimet që lidhen me ndërtimin e një tuneli me dy korsi me gjatësi 2.3 km dhe 14.5 m gjerësi; dhe

a. 3. Sektori 3 do të përfshijë punimet që lidhen me pjesën e rrugës nga portali i tunelit deri në qytetin e Elbasanit (11.8 km).

b) Shërbimet e konsulencës financojnë studimet e fizibilitetit dhe projektet inxhinierike, si dhe asistencën teknike për agjencinë zbatuese për procesin e prokurimit.

c) Njësia e menaxhimit të projektit (NJMP) mbulon kostot që lidhen me përvetësimin e tokës, planet e zhvendosjes dhe kompensimit, auditet financiare vjetore të llogarive të projektit, pagesat e stafit të NJMP-së, prokurimin e pajisjeve për zyra dhe një automjeti për mbikëqyrjen e projektit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROJEKTI I RRUGËS TIRANË-ELBASAN

PROGRAMI 2
ALOKIMI I HUAS

1. Përveçse kur bihet dakord ndryshe ndërmjet huamarrësit dhe menaxhimit të OFID-it, të ardhurat nga kredia prej \$20,400,000 përdoren për financimin e 20% të kostove të projektit të përshkruar në paragrafin (a), nënparagrafi (a.3) të skedulit 1 të kësaj marrëveshjeje.

2. Pavarësisht nga alokimi i të ardhurave të kredisë apo përqindja e disbursimit e përcaktuar në paragrafin 1 më sipër, nëse menaxhimi i OFID-it ka vlerësuar në mënyrë të arsyeshme se shumica e huas së alokuar në atë kohë sipas komponentit të specifikuar më sipër, do të jetë e pamjaftueshme për të financuar përqindjen e rënë dakort të të gjitha shpenzimeve të komponentit në fjalë, menaxhimi i OFID-it, duke njoftuar huamarrësin, mund të reduktojë përqindjen e disbursimit në atë kohë të zbatueshme për shpenzime të tilla, me qëllim që tërheqet e mëtejshme, për sa i përket komponentit në fjalë, të mund të vazhdojnë derisa të gjitha shpenzimet e parashikuara të jenë realizuar.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROJEKTI I RRUGËS TIRANË-ELBASAN

SKEDULI 3
AMORTIZIMI

	Data e shlyerjes	Shuma për t'u paguar (shprehur në dollarë)
1.	15 gusht 2016	680,000
2.	15 shkurt 2017	680,000
3.	15 gusht 2017	680,000
4.	15 shkurt 2018	680,000
5.	15 gusht 2018	680,000
6.	15 shkurt 2019	680,000
7.	15 gusht 2019	680,000
8.	15 shkurt 2020	680,000
9.	15 gusht 2020	680,000
10.	15 shkurt 2021	680,000
11.	15 gusht 2021	680,000
12.	15 shkurt 2022	680,000
13.	15 gusht 2022	680,000
14.	15 shkurt 2023	680,000
15.	15 gusht 2023	680,000
16.	15 shkurt 2024	680,000
17.	15 gusht 2024	680,000
18.	15 shkurt 2025	680,000
19.	15 gusht 2025	680,000
20.	15 shkurt 2026	680,000
21.	15 gusht 2026	680,000
22.	15 shkurt 2027	680,000
23.	15 gusht 2027	680, 000
24.	15 shkurt 2028	680,000
25.	15 gusht 2028	680,000
26.	15 shkurt 2029	680,000
27.	15 gusht 2029	680,000
28.	15 shkurt 2030	680,000
29.	15 gusht 2030	680,000
30.	15 shkurt 2031	680,000
	Totali:	20,400,000



OFID FONDI OPEC PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË ZBATUESHME PËR MARRËVESHJET E HUAS PËR
SEKTORIN PUBLIK
DHJETOR 2007

Tabela e lëndës

Neni 1

Dispozitat paraprahe

- 1.01 Emri dhe qëllimi
- 1.02 Kërkesa
- 1.03 Konflikti me marrëveshjen e huas

Neni 2

Përkufizimet dhe interpretimi

- 2.01 Përkufizimet
- 2.02 Interpretimi

Neni 3

Hyrja në fuqi

- 3.01 Data e hyrjes në fuqi

Neni 4

Marrëveshjet dhe përjashtimet

- 4.01 Prioriteti dhe barrët e huas
- 4.02 Barrët e përjashtuara
- 4.03 Të ardhurat e dhëna hua të huas
- 4.04 Mashtrimi dhe korrupsioni
- 4.05 Përjashtimi nga taksat
- 4.06 Konfidencialiteti
- 4.07 Shpronësimi dhe masa të ngjashme

Neni 5

Tërheqja e të ardhurave të huas

- 5.01 Tërheqja për shpenzimet e pranueshme
- 5.02 Kërkesa për tërheqje
- 5.03 Monedha e tërheqjes
- 5.04 Data e përfundimit të tërheqjes

Neni 6
Ekzekutimi i projektit

- 6.01 Standardi i ekzekutimit
- 6.02 Sigurimi
- 6.03 Prokurimi dhe përdorimi i mallrave
- 13
- 6.04 Dokumentet e projektit
- 6.05 Të dhënat e projektit, informacioni dhe inspektimi
- 6.06 Kërkesa për agjencinë zbatuese

Neni 7
Administratori i huas

- 7.01 Privilegjet e administratorit të huas
- 14
- 7.02 Konsultimi
- 15
- 7.03 Përfshirja e kushteve të administratorit të huas në marrëveshjen e huas

Neni 8
Përshpejtimi i maturitetit, pezullimi, anulimi

- 8.01 Përshpejtimi i huas
- 8.02 Anulimi nga huamarrësi
- 8.03 Anulimi dhe pezullimi nga OFID
- 8.04 Hyrja në fuqi e dispozitave pas pezullimit ose anulimit
- 8.05 Kërkesa e Anulimit

Neni 9
Prioriteti i marrëveshjes së huas, zbatueshmëria dhe arbitrazhi

- 9.01 Prioriteti i marrëveshjes së huas
- 9.02 Zbatueshmëria
- 9.03 Negociimi/Arbitrazhi

Neni 10
Të ndryshme

- 10.01 Mosushtrimi i të drejtave
- 10.02 Njoftimet dhe kërkesat
- 10.03 Autoriteti për marrjen e masave
- 10.04 Amendimi
- 10.05 Gjuha angleze
- 10.06 Përfundimi me pagesën e plotë



KUSHTET E PËRGJITHSHME TË OFID-IT
TË ZBATUESHME PËR MARRËVESHJET E HUAS TË SEKTORIT PUBLIK
DHJETOR 2007

Neni 1

Dispozitat paraprake

1.01 Emri dhe qëllimi

Këto kushte të përgjithshme përcaktojnë kushte dhe afate përgjithësisht të zbatueshme për huatë e bëra nga OFID, si pjesë e aktivitetit të huadhënies të sektorit publik të OFID-it dhe përmenden si “Kushte të përgjithshme të OFID-it të zbatueshme për marrëveshjet e huas të sektorit publik, dhjetor 2007”.

1.02 Kërkesa

Kushtet e përgjithshme zbatohen për çdo marrëveshje huaje të sektorit publik (duke përfshirë HIPC dhe marrëveshjet e huas të financimit tregtar) në atë masë dhe në bazë të ndryshimeve që mund të jepen në marrëveshjen përkatëse të huas. Në veçanti, në këto kushte të përgjithshme:

a) Termat e mëposhtëm zbatohen si më poshtë:

i) Termi “tarifat e shërbimit” zbatohet për marrëveshjet e huas në të cilat këto tarifa janë të pagueshme nga huamarrësi. Kur nuk janë të pagueshme këto tarifa, termi nuk do të merret në konsideratë;

ii) Termat “tarifat fillestare dhe/ose të detyrimit financiar” zbatohen, përkatësisht, për marrëveshjet e huas në të cilat tarifat fillestare dhe/ose të detyrimit financiar, janë të pagueshme nga huamarrësi. Kur këto tarifa janë të pagueshme, termat nuk do të merren në konsideratë;

iii) Termi “administrator i huas” zbatohet për huatë që administrohen nga një administrator huaje. Kur një hua administrohet nga OFID, neni 7, si dhe çdo referencë ndaj “administrator huaje” nuk do të merren në konsideratë; dhe

b) Seksionet e mëposhtme zbatohen si më poshtë:

i) Seksionet 4.01, 4.02 dhe, kur është e zbatueshme, seksioni 4.03 zbatohen për marrëveshjet e huas në të cilat huamarrësi është shtet ose qeveri;

ii) Seksionet 4.04, 4.05, 4.06 dhe 4.07 zbatohen për të gjitha marrëveshjet e huas.

1.03 Konflikti me marrëveshjen e huas

Në rast të konfliktit ose ndryshimit ndërmjet ndonjë dispozite në këto kushte të përgjithshme dhe një dispozite në një marrëveshje huaje, dispozita përkatëse në marrëveshjen e huas do të ketë përparësi.

Neni 2

Përkufizimet dhe interpretimi

2.01 Përkufizimet

Përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtëm kanë kuptimet e mëposhtme sa herë që përdoren në këto kushte të përgjithshme ose në marrëveshjen e huas:

a) “Përfaqësues i autorizuar i huamarrësit” nënkupton personin ose subjektin e emërtuar si të tillë në marrëveshjen e huas dhe të autorizuar rregullisht nga huamarrësi për marrjen e masave detyruese në emër të huamarrësit, në lidhje me marrëveshjen e huas;

b) “Bord” nënkupton bordin rregullator të OFID-it;

c) “Datë e mbylljes” nënkupton datën e përcaktuar në marrëveshjen e huas si datën në të cilën e drejta e huamarrësit për të kërkuar tërheqje nga huaja do të përfundojë, ose çdo shtyrje të kësaj date që menaxhimi i OFID-it mund të përcaktojë sipas seksionit 5.04;

- d) “Kontratë” nënkupton çdo kontratë për prokurimin e një kategorie të caktuar të mallrave, si për shembull, pa kufizim, punimet ose shërbimet profesionale dhe shërbime të tjera;
- e) “Praktikë korruptive” nënkupton ofrimin, dhënien, marrjen ose kërkimin e ndonjë elementi me vlerë për të ndikuar në veprimin e një zyrtari publik në prokurimin e mallrave ose ekzekutimin e një kontrate dhe përfshin, ndër të tjera, mitmarrjen dhe zhatjen ose shtrëngimin që përfshin kërcënime për plagosjen e një personi, dëmtimin e pronës ose reputacionit;
- f) “Datë e marrëveshjes” nënkupton datën në të cilën marrëveshja e huas është nënshkruar nga palët;
- g) “Datë e hyrjes në fuqi” nënkupton datën e përcaktuar në seksionin 3.01;
- h) “Procedurat e disbursimit” nënkupton procedurat e disbursimit të OFID-it të miratuara në maj 1983, një kopje e të cilave i është dhënë huamarrësit në datën e marrëveshjes;
- i) “Shpenzime të pranueshme” nënkupton çdo shpenzim të financuar nga të ardhurat e huas; me kusht që menaxhimi i OFID-it të ketë konstatuar se pagesa për këto shpenzime është: i) për financimin e kostos së arsyeshme të mallrave, siç përshkruhet në skedulën 2; dhe ii) të bëra në ose pas datës së fillimit të shpenzimeve të pranueshme dhe përpara datës së mbylljes;
- j) “Datë e fillimit të shpenzimeve të pranueshme” nënkupton datën në të cilën huaja është miratuar nga bordi; duke qenë data pas të cilës çdo shpenzim për financimin e kostos së arsyeshme të mallrave do të përbëjë *prima facie* shpenzime të pranueshme;
- k) “Agjenci zbatuese” nënkupton, kur huamarrësi është shtet ose qeveri, departamentin qeveritar ose çdo subjekt ose institucion tjetër të identifikuar në marrëveshjen e huas si agjencia që do të ekzekutojë projektin;
- l) “Borxh i jashtëm” nënkupton çdo borxh që është ose mund të bëhet i pagueshëm, ndryshe sesa në monedhën vendase;
- m) “Praktikë mashtruese” nënkupton një keqpërfaqësim të fakteve, me qëllim ndikimin në përzgjedhjen e një furnizuesi mallrash ose ekzekutimin e një kontrate, në dëm të huamarrësit, dhe përfshin praktikën bashkëpunuese midis individëve ose subjekteve të përfshira në prokurimin e mallrave ose ekzekutimin e një kontrate, për të privuar huamarrësin nga përfitimet e një konkurrence të lirë dhe të hapur;
- n) “Mallra” nënkupton pajisjet, furnizimet, punimet dhe shërbimet profesionale dhe shërbime të tjera të kërkuara për ekzekutimin e projektit;
- o) “Qeveri” nënkupton qeverinë qendrore të vendit të projektit;
- p) “Barrë” nënkupton barrët, pengjet, tarifat, privilegjet dhe prioritetin e çdo lloji;
- q) “Hua” nënkupton huan e parashikuar në marrëveshjen e huas;
- r) “Administrator i huas” nënkupton institucionin financiar të emërtuar në marrëveshjen e huas, i cili do të administrojë huan në bazë të kushteve që mund të bihen dakord ndërmjet këtij administratori huaje dhe OFID-it;
- s) “Marrëveshje huaje” nënkupton marrëveshjen e huas ndërmjet OFID dhe Huamarrësit, afati i të cilit përfshin këto kushte të përgjithshme që zbatohen për të, dhe të gjitha skedulet dhe marrëveshjet shtesë të marrëveshjes së huas;
- t) “Monedhë huaje” nënkupton monedhën në të cilën emërtohet huaja;
- u) “Monedhë vendase” nënkupton monedhën e vendit të projektit;
- v) “OFID” nënkupton Fondin e OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar, të krijuar nga shtetet anëtare të organizatës së vendeve eksportuese të naftës (OPEC) në bazë të marrëveshjes së nënshkruar në Paris, më 28 janar 1976, të ndryshuar;
- w) “Llogaria e OFID-it” nënkupton atë llogari bankare, të dhënat e të cilës i komunikohen herë pas here nga OFID huamarrësit;
- x) “Menaxhimi i OFID-it” nënkupton drejtorin e përgjithshëm të OFID-it ose çdo person të autorizuar sipas rregullave nga drejtori i përgjithshëm;
- y) “Udhëzimet e prokurimit” nënkupton udhëzimet e prokurimit sipas huave të dhëna nga



OFID të miratuara më 2 nëntor 1982, një kopje e të cilës i është dhënë huamarrësit në datën e marrëveshjes;

z) “Projekt” nënkupton projektin për të cilin është bërë huaja e përshkruar në skedulën 1, ose siç mund ta kërkojë konteksti, çdo pjesë të projektit;

aa) “Vend i projektit” nënkupton vendin ku ndodhet projekti;

bb) “Asete publike” nënkupton, për huamarrësit shtetërorë dhe qeveritarë, asetet e huamarrësit ose çdo nënndarjeje politike ose administrative të saj ose të çdo subjekti të zotëruar ose të kontrolluar, ose që funksionon për llogari ose përfitim të huamarrësit ose çdo nënndarje të tillë, duke përfshirë floririn dhe asetet e tjera të këmbimit të huaj valutor të mbajtur nga çdo institucion që përmbush funksionet e një banke qendrore ose fondi të stabilizimit të këmbimit valutor ose funksione të ngjashme, për huamarrësin;

cc) “Skedul” nënkupton një skedul në marrëveshjen e huas;

dd) “Tarifë shërbimi” nënkupton, në lidhje me hua të caktuara, një tarifë në normën e përcaktuar në marrëveshjen e huas, e cila do të paguhet nga huamarrësi në lidhje me shumën e principalit të huas të tërhequr dhe të papaguar. Qëllimi i tarifës së shërbimit është përmbushja e shpenzimeve të OFID-it në administrimin e huas; dhe

ee) “Taksat” përfshin taksat, detyrimet, tarifat dhe tatimet e çdo natyre, qoftë në fuqi në datën e marrëveshjes ose të vendosur më pas.

2.02 Interpretimi

Në çdo Marrëveshje huaje, nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe:

a) Titujt e neneve, seksioneve, skeduleve dhe tabelës së lëndës përfshihen në marrëveshjen e huas dhe në kushtet e përgjithshme vetëm për referencë dhe nuk merren në konsideratë në interpretimin e marrëveshjes së huas ose kushteve të përgjithshme.

b) Fjalët që tregojnë numrin njëjës përfshijnë shumësin dhe anasjelltas;

c) Një referencë ndaj një pale është një referencë ndaj një pale të marrëveshjes së huas; dhe një referencë ndaj një neni ose seksioni në marrëveshjen e huas është një referencë ndaj atij neni ose seksioni në marrëveshjen e huas; dhe një referencë ndaj një neni ose seksioni në kushtet e përgjithshme është një referencë ndaj atij neni ose seksioni në këto kushte të përgjithshme; dhe

d) Një referencë ndaj një dokumenti përfshin një ndryshim ose shtesë, ose zëvendësim të atij dokumenti por pa marrë parasysh asnjë ndryshim, shtesë ose zëvendësim të bërë në shkelje të Marrëveshjes përkatëse të huas.

Neni 3

Hyrja në fuqi

3.01 Data e hyrjes në fuqi

Pasi huamarrësi të ketë përmbushur kushtet e hyrjes në fuqi të përcaktuara në marrëveshjen e huas, të pranueshme për menaxhimin e OFID-it, marrëveshja e huas do të hyjë në fuqi dhe efekt të plotë në një datë të përcaktuar që do të komunikohet nga menaxhimi i OFID-it për huamarrësin. Data e përcaktuar në këtë mënyrë do të jetë data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes së huas.

Neni 4

Marrëveshjet dhe përjashtimet

4.01 Prioriteti i huas dhe barrët

Huamarrësi merr përsipër të garantojë se asnjë borxh tjetër i jashtëm nuk ka prioritet mbi huan, në lidhje me alokimin, realizimin ose shpërndarjen e këmbimit të huaj valutor të mbajtur nën kontroll ose për përfitim të huamarrësit. Për këtë qëllim, nëse krijohet ndonjë barrë për asetet

publike si garanci për ndonjë borxh të jashtëm që do të rezultojë ose mund të rezultonte në prioritet për përfitim të kreditorit të borxhit të jashtëm në alokimin, realizimin ose shpërndarjen e këmbimit të huaj valuator, barra, *ipso facto*, dhe pa kosto për OFID-in, siguron në mënyrë të njëjtë dhe proporcionale principalin, interesin, tarifën e shërbimit dhe tarifën fillestare dhe/ose tarifën e detyrimit financiar mbi huan dhe huamarrësi, në krijimin ose lejimin e krijimit të kësaj barre, do të parashikojë shprehimisht për këtë qëllim, megjithatë, me kusht që nëse për çdo arsye tjetër ligjore ose kushtetuese, ajo dispozitë nuk mund të bëhet në lidhje me ndonjë barrë të krijuar mbi asetet publike specifike, huamarrësi, menjëherë dhe pa kosto për OFID-in do të sigurojë principalin, interesin, tarifën e shërbimit dhe tarifën fillestare dhe/ose të detyrimit financiar mbi huanë, nga një barrë e barazvlefshme për asetet e tjera publike, të pranueshme për OFID-in.

4.02 Barrët e përjashtuara

Sipërmarrja e huamarrësit e përshkruar në seksionin 4.01 nuk zbatohet për:

a) Asnjë barrë të krijuar mbi pronën, në kohën e blerjes së saj, vetëm si garanci për pagesën e çmimit të blerjes së asaj prone ose si garanci për pagesën e borxhit të shkaktuar për qëllimin e financimit të blerjes së asaj prone; dhe

b) Çdo barrë që lind në kursin e zakonshëm të transaksioneve bankare dhe që siguron një borxh që maturohet jo më shumë se një vit pas datës së tij.

4.03 Të ardhurat e dhëna hua të huas

Kur bihen dakord që të ardhurat e huas t'i vihen në dispozicion një agjencie zbatuese, huamarrësi merr përsipër ndaj OFID-it t'i japë hua të ardhurat e huas asaj agjencie zbatuese për grandin ose mbi çdo bazë tjetër dhe në përputhje me ato kushte dhe afate që mund të jenë të pranueshme për menaxhimin e OFID-it.

4.04 Mashtrimi dhe korrupsioni

Huamarrësi merr përsipër në mënyrë të parevokueshme dhe të pakushtëzuar ndaj OFID-it se huamarrësi do të vërë në funksionim të gjitha masat e nevojshme për të garantuar se as prokurimi i mallrave, as ekzekutimi i ndonjë kontrate nuk do të përfshijë praktika korruptive ose praktika mashtruese.

4.05 Përjashtimi nga taksat

Të gjitha taksat në vendin e projektit, qoftë në lidhje me ekzekutimin, dorëzimin ose regjistrimin e marrëveshjes së huas ose çdo marrëveshjeje shtesë ndërmjet palëve, do të përballohen nga huamarrësi. Principali, interesi, tarifën e shërbimit dhe tarifën fillestare dhe/ose të detyrimit financiar mbi huan do të paguhet pa zbritje dhe të lira nga çdo lloj takse.

4.06 Konfidencialiteti

Të gjitha dokumentet e OFID-it, të dhënat, korrespondenca dhe materiale të ngjashme konsiderohen konfidenciale nga huamarrësi dhe në veçanti, përjashtohen nga çdo formë e njoftimit në vendin e projektit, nëse nuk bihet dakord ndryshe nga menaxhimi i OFID-it.

4.07 Shpronësimi dhe masa të ngjashme

Asetet e OFID-it nuk i nënshtrohen asnjë forme shpronësimi ose shtetëzimi, sekuestrimi, ruajtjeje ose konfiskimi në vendin e projektit.

Neni 5

Tërheqja e të ardhurave të huas

5.01 Tërheqja për shpenzimet e pranueshme

Pasi Marrëveshja e huas të jetë shpallur në fuqi dhe nëse huamarrësi dhe menaxhimi i OFID-it nuk bien dakord ndryshe, huaja mund të disbursohet herë pas here për të plotësuar shpenzimet e pranueshme, në përputhje të plotë me skedulën 2.

5.02 Kërkesa për tërheqje

Kërkesat për tërheqjen e të ardhurave të huas përgatiten në përputhje me procedurat e



disbursimit. Kur huaja administrohet nga një administrator huaje, kërkesat për tërheqje përgatiten në dy kopje të njësuara me origjinalin, njëra prej të cilave i dorëzohet OFID-it nga përfaqësuesi i autorizuar i huamarrësit; tjetra i dorëzohet administratorit të huas. Çdo kërkesë për tërheqje shoqërohet me ato dokumente dhe prova të tjera të mjaftueshme në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Menaxhimin e OFID-it dhe administratorin e huas se huamarrësi ka të drejtë të tërheqë shumën e kërkuar dhe se shuma përbën shpenzimet e pranueshme.

5.03 Monedha e tërheqjes

Përveç kur menaxhimi i OFID-it bie dakord ndryshe, disbursimet e huas mund të bëhen në monedhat në të cilat janë paguar ose janë të pagueshme shpenzimet e pranueshme. Në rast se do të kërkohej një tërheqje në një monedhë të ndryshme nga monedha e huas, disbursimi do të kryhet mbi bazën e kostos aktuale të monedhës së huas të shkaktuar nga OFID në plotësimin e kërkesës. Menaxhimi i OFID-it do të veprojë në blerjen e monedhave si agjenti i huamarrësit. Disbursimet për shpenzimet e pranueshme në monedhën vendase, nëse ka, bëhen në monedhën e huas sipas normës zyrtare përkatëse të këmbimit, dhe në mungesë të kësaj norme, sipas një norme të arsyeshme që menaxhimi i OFID-it do të vendosë herë pas here.

5.04 Data e fundit e tërheqjes

E drejta e huamarrësit për të tërhequr të ardhurat e huas do të përfundojë në datën e mbylljes ose në atë datë të mëvonshme që do të vendoset nga menaxhimi i OFID-it. Menaxhimi i OFID-it do të informojë menjëherë huamarrësin për këtë datë të mëvonshme.

Neni 6

Ekzekutimi i projektit

6.01 Standardi i ekzekutimit

a) Huamarrësi:

- i) ekzekuton projektin me kujdes dhe efektivitet, dhe në përputhje me praktikat e qëndrueshme administrative, ekonomike, financiare, teknike dhe mjedisore;
- ii) vë në dispozicion, menjëherë sipas nevojës, fondet, shërbimet, ambientet, tokën dhe burimet e tjera që kërkohen, përveç huas, për ekzekutimin e projektit; dhe
- c) Kur huamarrësi është një shtet ose qeveri, ai do të garantojë se aktivitetet e departamenteve dhe agjencive të tij në lidhje me ekzekutimin e projektit janë kryer dhe bashkërenduar në përputhje me procedurat dhe politikat e qëndrueshme administrative.

6.02 Siguracioni

Huamarrësi merr përsipër të regjistrojë siguracion të mjaftueshëm për mallrat kundër rreziqeve që lidhen me blerjen, transportimin dhe dorëzimin e tyre në vendin e përdorimit ose instalimit. Në lidhje me këto mallra, çdo dëmshpërblim siguracioni do të jetë i pagueshëm në një monedhë lirisht të përdorshme për të zëvendësuar ose riparuar mallrat. Për më tepër, huamarrësi do të regjistrojë ato siguracione të tjera mbi mallrat që menaxhimi i OFID-it mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme.

6.03 Prokurimi dhe përdorimi i mallrave

Mallrat do të përdoren vetëm për qëllimet e projektit. Sipas rastit, referenca ndaj kostos së mallrave konsiderohet të përfshijë edhe koston e importimit të këtyre mallrave për vendin e projektit. Përveç kur menaxhimi i OFID-it do të bjerë dakord ndryshe, prokurimi i mallrave do të jetë përgjithësisht në përputhje me udhëzimet e prokurimit ose me ato procedura të tjera që pajtohen thelbësisht me to, të cilat mund të jenë të pranueshme për menaxhimin e OFID-it, duke përfshirë udhëzime ose instrumente të tjera me efekte të ngjashme të lëshuara nga administratori i huas.

6.04 Dokumentet e projektit

Huamarrësi i jep OFID-it dhe administratorit të huas, menjëherë pas përgatitjes së tyre,

planet, specifikimet, dokumentet e kontratës dhe skedulet e ndërtimit dhe prokurimit për projektin dhe çdo ndryshim material ose shtesa të tyre, në ato hollësira që menaxhimi i OFID-it dhe administratori i huas do të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme.

6.05 Të dhënat e projektit, informacioni dhe inspektimi

Huamarrësi:

a) Mban të dhëna dhe procedura të mjaftueshme për të regjistruar dhe monitoruar progresin e projektit (duke përfshirë koston e tij dhe përfitimet që do të rrjedhin i), për të identifikuar mallrat dhe për të njoftuar në lidhje me përdorimin e tyre në projekt;

b) Ruan të dhëna të mjaftueshme për të reflektuar, në përputhje me praktikën e kontabilitetit të mbajtura në mënyrë të qëndrueshme, operacionet, burimet dhe shfrytëzimin e shpenzimeve të pranueshme, dhe kur huamarrësi është një shtet ose qeveri, i departamenteve ose agjencive të huamarrësit, përgjegjëse për zbatimin e projektit, dhe do të vërë këto të dhëna në dispozicion të OFID-it dhe administratorit të huas, sipas kërkesës së çdo pale;

c) I jep mundësinë përfaqësuesve të OFID-it dhe administratorit të huas të vizitojnë ambientet e projektit dhe sheshet e ndërtimit dhe të shqyrtojnë mallrat dhe çdo të dhënë dhe dokument në lidhje me to;

d) I jep OFID-it dhe administratorit të huas të gjithë këtë informacion, si dhe raporte tremujore dhe raporte të tjera që menaxhimi i OFID dhe administratori i huas do të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme, në lidhje me projektin në përgjithësi, zbatimin e tij në përputhje me marrëveshjen e huas dhe prova të shfrytëzimit të të ardhurave të huas për shpenzimet e pranueshme; dhe

e) Menjëherë pas përfundimit të projektit, por në çdo rast jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas datës së mbylljes, ose në një datë të mëvonshme që mund të bihet dakord për këtë qëllim pas konsultimit ndërmjet huamarrësit, menaxhimit të OFID-it dhe administratorit të huas, të përgatisë dhe t'i japë OFID-it dhe administratorit të huas:

i) një raport të kësaj fushe veprimi dhe në hollësira që menaxhimi i OFID-it dhe administratori i huas do të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme mbi ekzekutimin dhe funksionimin fillestar të projektit, kostot dhe fitimet e tij që rrjedhin dhe që do të rrjedhin, përmbushja nga huamarrësi dhe OFID i detyrimeve të tyre përkatëse sipas marrëveshjes së huas dhe realizimi i qëllimeve të huas; dhe

ii) një plan të projektuar për të garantuar qëndrueshmërinë e arritjeve të projektit.

6.06 Kërkesa për agjencinë zbatuese

Kur huamarrësi është shtet ose qeveri, të gjitha referencat ndaj huamarrësit në nenin 6, interpretohen *mutatis mutandis* sikur përfshijnë referenca ndaj agjencisë zbatuese.

Neni 7

Administratori i huas

7.01 Privilegjet e administratorit të huas

Kur një hua administrohet nga një administrator huaje, huamarrësi, përveç përmbushjes së detyrimeve të tij ndaj këtij administratori huaje, siç parashikohet në seksionet 5.02, 6.04 dhe seksioneve 6.05 (b), (c), (d) dhe (e):

a) Bashkëpunon plotësisht me këtë administrator huaje për të garantuar përmbushjen e qëllimeve të huas;

b) Shkëmben mendime me menaxhimin e OFID-it dhe administratorin e huas në lidhje me progresin e projektit dhe arritjen e qëllimeve të huas; dhe

c) Informon menjëherë menaxhimin e OFID-it dhe administratorin e huas në lidhje me çdo gjendje që ndërhyrë ose rrezikon të ndërhyjë në progresin e projektit ose përmbushjen nga huamarrësi të detyrimeve të tij sipas marrëveshjes së huas.



7.02 Konsultimi

Huamarrësi do të konsultohet me OFID-in përpara se të bjerë dakord me administratorin e huas për ndryshimet në këtë gjendje në lidhje me ekzekutimin ose administrimin e projektit. Asnjë ndryshim i tillë nuk do të konsiderohet të jetë përfshirë në marrëveshjen e huas, pa pëlqimin paraprak me shkrim të menaxhimit të OFID-it.

7.03 Përfshirja e kushteve të administratorit të huas në marrëveshjen e huas

Pavarësisht nga ndonjë element në nenin 7 për të kundërtën, huamarrësi, në masën që është e përputhshme me marrëveshjen e huas, përballë OFID-it, u përmbahet të gjitha këtyre kushteve të lidhura me ekzekutimin dhe administrimin e projektit që huamarrësi pranon në marrëveshjen e tij të huas të nënshkruar ose që do të nënshkruhet me administratorin e huas për financimin e pjesshëm të projektit; ndërsa referencat ndaj administratorit të huas në këtë marrëveshje konsiderohen për qëllime të këtij seksioni të jenë referenca ndaj OFID-it.

Neni 8

Përsheptimi i maturitetit, pezullimi, anulimi

8.01 Përsheptimi i huas

Nëse ndonjë prej rasteve të përcaktuara në këtë seksion do të ndodhë, ose sipas rastit, konstatohet ndodhja e një veprimi të paligjshëm në lidhje me prokurimin e mallrave ose ekzekutimin e një kontrate, atëherë, në çdo kohë të mëtejshme gjatë vazhdimit të asaj ngjarjeje, ose sipas rastit, menjëherë pas konstatimit të tij, OFID me anë të një njoftimi ndaj huamarrësit, mund të shpallë principalin e huas në të atë kohë të papaguar, si menjëherë të kërkueshëm dhe të pagueshëm, së bashku me interesin, tarifat e shërbimit dhe tarifat fillestare dhe/ose të detyrimeve financiare mbi to, dhe në këtë rast, principalin, së bashku me interesin dhe të gjitha tarifat dhe detyrimet, do të bëhet menjëherë i kërkueshëm dhe i pagueshëm:

a) Një mospërbushje detyrimesh do të ndodhë dhe vazhdojë për një periudhë prej tridhjetë (30) ditësh në pagimin e çdo kësti të principalit, interesit, tarifave të shërbimit dhe tarifave fillestare dhe/ose të detyrimit financiar, sipas marrëveshjes së huas ose sipas çdo marrëveshjeje tjetër në bazë të të cilës huamarrësi ka marrë ose do të ketë marrë një hua nga OFID;

b) Një mospërbushje detyrimesh do të ndodhë në përbushjen e çdo detyrimi nga ana e huamarrësit sipas marrëveshjes së huas, i ndryshëm nga një mospërbushje e mbuluar sipas paragrafit (a) më lart, dhe kjo mospërbushje detyrimesh do të vazhdojë për një periudhë prej gjashtëdhjetë (60) ditësh pasi njoftimi për këtë të jetë dhënë nga menaxhimi i OFID-it për huamarrësin; ose

c) Menaxhimi i OFID-it ka konstatuar ndodhjen e praktikave korruptive ose praktikave mashtruese në lidhje me prokurimin e mallrave ose ekzekutimin e ndonjë kontrate.

8.02 Anulimi nga huamarrësi

Me anë të një njoftimi për OFID-in, huamarrësi mund të anulojë çdo shumë të huas që huamarrësi nuk do të ketë tërhequr përpara dhënies së këtij njoftimi.

8.03 Anulimi dhe pezullimi nga OFID

OFID, me anë të një njoftimi ndaj huamarrësit, mund të pezullojë ose t'i japë fund të drejtës së huamarrësit për të bërë tërheqje nga huaja, nëse:

a) Ndonjë prej rasteve të përcaktuara në seksionin 8.01 do të ndodhë, ose sipas rastit, konstatohet ndodhja e një veprimi të paligjshëm në lidhje me prokurimin e mallrave ose ekzekutimin e kontratës; ose

b) E drejta e huamarrësit për të bërë tërheqje sipas një huaje tjetër për projektin do të jetë pezulluar ose anuluar; ose

c) Do të ketë lindur çdo situatë tjetër e jashtëzakonshme që do ta bënte të pamundur kryerjen

në mënyrë të suksesshme të projektit ose që huamarrësi të jetë i aftë të përmbushë detyrimet e tij sipas marrëveshjes së huas.

8.04 Hyrja në fuqi e dispozitave pas pezullimit ose anulimit

Pavarësisht nga përshpejtimi i maturitetit të huas sipas seksionit 8.01 ose anulimit të saj sipas seksionit 8.02, ose anulimit ose pezullimit të saj sipas seksionit 8.03, të gjitha dispozitat e marrëveshjes së huas do të mbeten në fuqi dhe efekt të plotë, përveç rasteve kur bihet dakord ndryshe nga OFID.

8.05 Kërkesa e anulimit

Nëse nuk bihet dakord ndryshe ndërmjet huamarrësit dhe OFID-it, pas çdo anulimi të ndonjë pjese të huas, disa maturitete të shumës së principalit të huas do të zvogëlohen në të njëjtin nivel që anulimi ka lidhje me shumën e plotë të huas përpara këtij anulimi.

Neni 9

Prioriteti i marrëveshjes së huas, zbatueshmëria dhe arbitrazhi

9.01 Prioriteti i marrëveshjes së huas

Marrëveshja e huas dhe të gjitha dokumentet e ekzekutuara në lidhje me të, dhe vlefshmëria, zbatueshmëria dhe interpretimi i tyre, si dhe të gjitha mosmarrëveshjet që lindin sipas çdo dokumenti të tillë, rregullohen nga dispozitat e marrëveshjes së huas dhe parimet e zbatueshme të drejtës ndërkombëtare.

9.02 Zbatueshmëria

Të drejtat dhe detyrimet e palëve të marrëveshjes së huas janë të vlefshme dhe të zbatueshme në përputhje me kushtet e tyre, pavarësisht çdo dispozite në ligjin e ndonjë shteti për të kundërtën. Asnjë palë e marrëveshjes së huas nuk ka të drejtë për procedim sipas këtij neni për të pohuar pretendimin se ndonjë dispozitë e marrëveshjes së huas është e pavlefshme ose e pazbatueshme për ndonjë arsye.

9.03 Negociimi/arbitrazhi

Çdo mosmarrëveshje, konflikt ose pretendim që lind nga ose në lidhje me marrëveshjen e huas ose shkelja, përfundimi ose pavlefshmëria e tyre ose që ndryshe lidhen me interpretimin ose zbatimin e marrëveshjes së huas që nuk është zgjidhur nëpërmjet bisedimit, i paraqitet, sipas kërkesës së çdo pale, një gjykatë arbitrazhi për vendim detyrues në përputhje me sa më poshtë:

a) Procedimet e arbitrazhit mund të fillohen nga huamarrësi kundër OFID-it ose anasjelltas. Në të gjitha rastet, procedimet e arbitrazhit fillohen me një njoftim të dhënë nga pala ankuese për palën e paditur;

b) Gjykata e arbitrazhit përbëhet nga tre arbitra që do të caktohen si më poshtë: një nga pala ankuese; një i dytë nga pala e paditur dhe i treti (Gjyqtari i Arbitrazhit) me marrëveshje të dy arbitrave. Nëse brenda tridhjetë (30) ditësh pas njoftimit të fillimit të procedimeve të arbitrazhit, pala e paditur nuk mund të emërojë një arbitër, ky arbitër do të caktohet nga kryetari i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, me kërkesë të palës që fillon procedimin. Nëse dy arbitrat nuk bien dakord për gjyqtarin e arbitrazhit brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh pas datës së caktimit të arbitrit të dytë, ky gjyqtar arbitrazhi do të caktohet nga kryetari i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë;

c) Arbitrazhi zhvillohet në një shtet (që nuk është vendi i projektit ose ndonjë shtet anëtar i OFID-it) që është palë e Konventës së Kombeve të Bashkuara për Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit, të bërë në Nju Jork, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, më 10 qershor 1958; dhe gjuha angleze do të përdoret në të gjitha procedimet e arbitrazhit;

d) Gjykata e arbitrazhit do të përcaktojë të gjitha çështjet e procedurës dhe çështjet në lidhje me kompetencën e saj;



e) Të gjitha vendimet e gjykatës arrihen me shumicë votash. Vendimi i arbitrazhit që mund të jepet edhe nëse njëra palë mungon, është i formës së prerë dhe detyrues për të dyja palët e procedimit;

f) Dërgimi i çdo njoftimi ose njoftimi i çdo procesi në lidhje me ndonjë procedim sipas këtij neni ose në lidhje me procedimet për zbatimin e një vendimi të dhënë sipas këtij neni, bëhet në adresën e palës përkatëse në përputhje me, dhe i rregulluar nga seksioni 10. 02; dhe

g) Gjykata e arbitrazhit vendos nëse kostoja e arbitrazhit do të përballohet nga njëra ose të dyja palët e procedimit.

Neni 10 Të ndryshme

10.01 Pamundësia për ushtrimin e të drejtave

Asnjë vonesë nga OFID në ushtrimin ose mosveprimin për të ushtruar ndonjë të drejtë sipas marrëveshjes së huas pas ndonjë mosplotësimi detyrimesh, nuk cenon këtë të drejtë ose nuk interpretohet si heqje dorë prej saj; as veprimi nga OFID në lidhje me mospërmbushje detyrimesh, nuk cenon ose dëmton të drejtat e OFID-it në lidhje me ndonjë mospërmbushje tjetër ose të mëtejshme detyrimesh.

10. 02 Njoftimet dhe kërkesat

Çdo njoftim ose kërkesë e kërkuar ose e lejuar të jepet ose bëhet sipas marrëveshjes së huas do të jetë me shkrim. Ky njoftim ose kjo kërkesë do të konsiderohet të jetë dhënë ose bërë sipas rregullave, kur t'i jetë dërguar dorazi, me postë ose telefaks palës të cilës kërkohet t'i jepet ose bëhet, në adresën e palës së përcaktuar në marrëveshjen e huas ose në çdo adresë tjetër që pala do t'i ketë përcaktuar me shkrim palës që jep njoftimin ose që bën kërkesën.

10.03 Autoriteti për marrjen e masave

Çdo masë e kërkuar ose e lejuar të merret dhe çdo dokument i kërkuar ose i lejuar të ekzekutohet sipas marrëveshjes së huas në emër të huamarrësit, do të merret ose ekzekutohet nga përfaqësuesi i autorizuar i huamarrësit ose çdo person tjetër i autorizuar me shkrim nga ky përfaqësues i autorizuar.

10. 04 Amendimi

Çdo amendim i marrëveshjes së huas mund të propozohet nga çdo palë dhe bihet dakord në emër të huamarrësit, me instrument me shkrim të ekzekutuar nga përfaqësuesi i autorizuar i huamarrësit ose në çdo mënyrë tjetër që menaxhimi i OFID-it mund të përcaktojë; me kusht që sipas mendimit të këtij përfaqësuesi, ndryshimi të jetë i arsyeshëm sipas rrethanave dhe të mos rrisë ndjeshëm detyrimet e huamarrësit sipas marrëveshjes së huas.

10. 05 Gjuha angleze

Çdo dokument i dorëzuar sipas marrëveshjes së huas është në gjuhën angleze. Dokumentet në çdo gjuhë tjetër shoqërohen me një përkthim të tyre në gjuhën angleze, të vërtetuar si një përkthim i miratuar dhe ky përkthim i miratuar është përfundimtar.

10. 06 Përfundimi me pagesën e plotë

Kur e tërë shuma e principalit të huas së tërhequr, interesi që do të ishte shtuar, tarifat e shërbimit dhe tarifat fillestare dhe/ose të detyrimit financiar të pagueshme mbi to, do të jenë paguar plotësisht dhe marrë në llogarinë e OFID-it, marrëveshja e huas dhe të gjitha detyrimet e palëve sipas kësaj marrëveshjeje, do të përfundojnë menjëherë.

OFID Fondi i OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar

Parkring 8, 1010 Vienna Austria

P.O.Box 995, A-1011 Vienna, Austria

Tel.: +43-1-515 64-0

Telefaks: +43-1-5139238

www.ofid.org

LIGJ
Nr. 40/2012

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
(IBRD) PËR FINANCIMIN SHITESË TË PROJEKTIT “SIGURIA E DIGAVE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin shtesë të projektit “Siguria e digave”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 12.4.2012

Shpallur me dekretin nr. 7411 datë 23.4.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Numri i huas _____

KOMUNITETI I ENERGIJISË I PROGRAMIT TË EUROPËS JUGLINDORE

MARRËVESHJE HUAJE

**(FINANCIM SHITESË PËR PROJEKTIN E SIGURISË SË DIGAVE) NDËRMJET SHQIPËRISË
DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM**

DATE _____, 201 _____

Marrëveshje e datës _____, 201 _____ ndërmjet Shqipërisë (huamarrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (banka) për qëllimin e sigurimit të financimit shtesë për projektin fillestar (siç përcaktohet në shtojcën e kësaj marrëveshjeje). Me anë të kësaj marrëveshjeje, huamarrësi dhe banka bie dakord si më poshtë:

Neni 1

Kushtet e përgjithshme, përkufizimet

1.01 Kushtet e përgjithshme (siç përcaktohet në shtojcën e kësaj marrëveshjeje) përbëjnë pjesë integrale të kësaj marrëveshjeje.



1.02. Nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe, termat me germa kapitale të përdorura në këtë marrëveshje kanë kuptimet e dhëna atyre në kushtet e përgjithshme ose në shtojcën e kësaj marrëveshjeje.

Neni 2 Huaja

2.01 Banka bie dakord t'i japë huamarrësit hua, në bazë të kushteve dhe afateve të përcaktuara ose të përmendura në këtë marrëveshje, shumën prej pesëmbëdhjetë milionë e pesëqind mijë eurosh (€15,500,000), siç kjo shumë mund të konvertohet herë pas here nëpërmjet një këmbimi të monedhës, në përputhje me dispozitat e seksionit 2.07 të kësaj marrëveshjeje (huaja), për të ndihmuar për financimin e projektit të përshkruar në skedulin 1 të kësaj marrëveshjeje (projekti).

2.02 Huamarrësi mund të tërheqë të ardhurat e huas në përputhje me seksionin IV të skedulit 2 të kësaj marrëveshjeje.

2.03 Tarifa fillestare e pagueshme nga huamarrësi është e barabartë me një të katërtën e një për qind (0.25%) të shumës së huas.

2.04 Interesi i pagueshëm nga huamarrësi për çdo periudhë interesi është në një normë të barabartë me normën referuese për monedhën e huas, plus marzhin e ndryshueshëm; me kusht që pas një konvertimi të të gjithë ose një pjese të shumës së principalit të huas, interesi i pagueshëm nga huamarrësi gjatë periudhës së konvertimit për këtë shumë, do të përcaktohet në përputhje me dispozitat përkatëse të nenit 4 të kushteve të përgjithshme. Pavarësisht nga sa më sipër, nëse ndonjë shumë e balancës së tërhequr të huas mbetet e papaguar kur kërkohet dhe ky mospagim vazhdon për një periudhë prej tridhjetë ditësh, interesi i pagueshëm nga huamarrësi do të llogaritet siç parashikohet në seksionin 3.02 (e) të kushteve të përgjithshme.

2.05 Datat e pagesës janë 15 maj dhe 15 nëntor të çdo viti.

2.06 Shuma e principalit të huas shlyhet në përputhje me skedulin e amortizimit në skedulin 3 të kësaj marrëveshjeje.

2.07 a) Huamarrësi mund të kërkojë në çdo kohë ndonjë prej konvertimeve të mëposhtme të kushteve të huas, me qëllim lehtësimin e menaxhimit të duhur të borxhit: i) një ndryshim të monedhës së huas të të gjithë ose një pjese të shumës së principalit të huas, të tërhequr ose të patërhequr, në një monedhë të aprovuar; dhe ii) një ndryshim të bazës së normës së interesit të zbatueshme për të gjithë ose një pjesë të shumës së principalit të huas të tërhequr dhe të papaguar nga një normë e ndryshueshme në një normë të fiksuar, ose anasjelltas ose nga një normë e ndryshueshme e bazuar në një marzh të ndryshueshëm në një normë të ndryshueshme të bazuar në një marzh të fiksuar.

b) Çdo konvertim i kërkuar sipas paragrafit (a) të këtij seksioni që pranohet nga banka, konsiderohet "konvertim", siç përcaktohet në kushtet e përgjithshme dhe kryhet në përputhje me dispozitat e nenit 4 të kushteve të përgjithshme dhe udhëzimet e konvertimit.

Neni 3 Projekti

3.01 Huamarrësi deklaron angazhimin e tij për objektivat e projektit dhe programit. Për këtë qëllim, huamarrësi realizon projektin nëpërmjet njësisë zbatuese të projektit në përputhje me dispozitat e nenit 5 të kushteve të përgjithshme dhe marrëveshjen e projektit.

3.02 Pa u kufizuar në dispozitat e seksionit 3.01 të kësaj marrëveshjeje dhe përveç kur huamarrësi dhe Banka bien dakord ndryshe, huamarrësi garanton se projekti kryhet në përputhje me dispozitat e skedulit 2 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 4
Mjetet ligjore të bankës

4.01 Rasti shtesë i pezullimit përfshin rastin kur legjislacioni i njësisë zbatuese të projektit është ndryshuar, pezulluar, shfuqizuar, tërhequr ose hequr dorë në një mënyrë që ndikon negativisht dhe materialisht tek aftësia e njësisë zbatuese të projektit për përmbushjen e detyrimeve të saj sipas marrëveshjes së projektit.

4.02 Afati i bashkëfinancimit për hyrjen në fuqi të marrëveshjes së bashkëfinancimit të BERZH-it, i përcaktuar në paragrafin 6 (a) të shtojcës së kësaj marrëveshjeje, është data 1 korrik 2012.

Neni 5
Hyrja në fuqi; përfundimi

5.01 Kushti shtesë për hyrjen në fuqi përfshi rastin kur marrëveshja e nënhuas është nënshkruar në emër të huamarrësit dhe njësisë për zbatimin e projektit.

5.02 Çështjet ligjore shtesë përfshijnë rastin kur marrëveshja e nënhuas është autorizuar ose ratifikuar sipas rregullave nga huamarrësi dhe nga njësia për zbatimin e projektit dhe është ligjërisht detyruese për huamarrësin dhe njësinë e zbatimit të projektit, në përputhje me kushtet e saj.

5.03 Afati për hyrjen në fuqi është data që bie nëntëdhjetë (90) ditë pas datës së nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.

Neni 6
Përfaqësuesit; adresat

6.01 Përfaqësuesi i huamarrësit është Ministri i Financave.

6.02 Adresa e huamarrësit është:

Ministria e Financave

Nr. 4 Bulevardi “Dëshmorët e kombit”

Tiranë, Shqipëri

Faks: 355-4222-8494

6.03 Adresa e Bankës është:

International Bank of Reconstruction and Development

1818 H Street, N.W.

Washington, D.C. 20433

United States of America

Adresa kabllore:

INTBAFRAD

Washington, D.C.

Teleks:

248423 (MCI) ose

64145 (MCI)

Faks:

1-202-477-6391

Rënë dakord në _____, _____ në ditën dhe vitin e shkruar fillimisht më sipër.



SHQIPËRIA

Nga

Përfaqësuesi i autorizuar

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR

RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga

Përfaqësuesi i autorizuar

SKEDULI I PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Objektivat e projektit janë: i) të kontribuojë në mbrojtjen e digave hidroelektrike të kaskadave të lumit Drin dhe Mat në territorin e huamarrësit; dhe ii) të përmirësojë efektivitetin operacional të digave të lartpërmendura hidroelektrike dhe të përmirësojë qëndrueshmërinë e furnizimit me energji në tregun rajonal.

Projekti përfshin fazën e pestë të programit dhe përbëhet nga projekti fillestar.

SKEDULI 2 REALIZIMI I PROJEKTIT

SEKSIONI I MASAT ZBATUESE

A. MARRËVESHJA E NËNHUAS

1. Për të lehtësuar realizimin e projektit, huamarrësi do të verë në dispozicion të njësisë së zbatimit të projektit të ardhurat e huas, sipas një marrëveshjeje nënhuaje ndërmjet huamarrësit dhe njësisë së zbatimit të projektit, në bazë të kushteve dhe afateve të aprovuara nga banka (marrëveshja e nënhuas).

2. Huamarrësi ushtron të drejtat e tij sipas marrëveshjes së nënhuas, me qëllim që të mbrojë interesat e huamarrësit dhe bankës dhe të përmbushë qëllimet e huas. Përveç kur banka bie dakord ndryshe, huamarrësi nuk transferon, ndryshon, shfuqizon ose heq dorë nga marrëveshja e nënhuas ose ndonjë prej dispozitave të saj.

B. ANTIKORRUPSIONI

Huamarrësi garanton se projekti është realizuar në përputhje me dispozitat e udhëzimeve antikorruption.

SEKSIONI II RAPORTI I MONITORIMIT TË PROJEKTIT DHE VLERËSIMI

A. RAPORTET E PROJEKTIT

1. Huamarrësi monitoron dhe vlerëson dhe merr masa që NJZP të monitorojë dhe të vlerësojë ecurinë e projektit dhe përgatit raportet e projektit në përputhje me dispozitat e seksioni 5.08 të kushteve të përgjithshme dhe mbi bazën e treguesve të rënë dakord me bankën. Çdo raport projekti mbulon periudhën e një semestri kalendarik dhe i jepet bankës jo më vonë se dy (2) pas përfundimit të periudhës së mbuluar nga ky raport.

2. Për qëllime të seksionit 5.08 (c) të kushteve të përgjithshme, raporti mbi realizimin e projektit dhe plani përkatës i kërkuar sipas këtij seksioni do t'i jepet bankës jo më vonë se gjashtë muaj para datës së përfundimit.

B. MENAXHIMI FINANCIAR, RAPORTET FINANCIARE DHE AUDITET

1. Huamarrësi merr masa që NJZP të administrojë një sistem të menaxhimit financiar në përputhje me dispozitat e seksionit 5.09 të kushteve të përgjithshme.

2. Pa u kufizuar në dispozitat e pjesës A të këtij seksioni, huamarrësi merr masa që NJZP të përgatisë dhe t'i japë bankës jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë pas përfundimit të çdo semestri kalendarik, raporte të përkohshme financiare të paaudituar për projektin që mbulojnë semestrin, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për bankën.

3. Huamarrësi merr masa që NJZP të sigurojë auditimin e pasqyrave financiare, në përputhje me dispozitat e seksionit 5.09 (b) të kushteve të përgjithshme. Çdo audit i pasqyrave financiare mbulon periudhën e një viti fiskal të huamarrësi. Pasqyrat e audituara financiare për çdo periudhë të tillë i jepen bankës jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas përfundimit të kësaj periudhe.

**SEKSIONI III
PROKURIMI**

A. TË PËRGJITHSHME

1. Mallrat dhe punimet. Të gjitha mallrat dhe punimet e kërkuara për projektin që duhet të financohen nga të ardhurat e huas, prokurohen në përputhje me kërkesat e përcaktuara ose të përmendura në seksionin I të udhëzimeve të prokurimit dhe dispozitat e këtij seksioni.

2. Shërbimet e konsulentëve. Të gjitha shërbimet e konsulentëve të kërkuara për projektin dhe që duhet të financohen nga të ardhurat e huas, prokurohen në përputhje me kërkesat e përcaktuara ose të përmendura në seksionet I dhe IV të udhëzimeve të konsulentëve dhe dispozitat e këtij seksioni.

3. Përkufizimet. Termet me germa kapitale të përdorur më poshtë në këtë seksion për të përshkruar metoda të veçanta prokurimi ose metoda rishikimi nga banka, të kontratave të caktuara, i referohen metodës përkatëse të përshkruar në seksionet II dhe III të udhëzimeve të prokurimit ose sipas rastit, seksioneve II, III, IV dhe V të udhëzimeve të konsulentëve.

B. METODA TË VEÇANTA TË PROKURIMIT TË MALLRAVE DHE PUNIMEVE

1. Ofertimi konkurrues ndërkombëtar. Përveç kur parashikohet ndryshe në paragrafin 2 më poshtë, mallrat dhe punimet prokurohen sipas kontratave të dhëna mbi bazën e ofertimit konkurrues ndërkombëtar.

2. Metoda të tjera të prokurimit të mallrave dhe punimeve. Tabela e mëposhtme përcakton metodat e prokurimit, përveç ofertimit konkurrues ndërkombëtar, që mund të përdoren për mallrat dhe punimet. Plani i prokurimit përcakton rrethanat sipas të cilave mund të përdoren këto metoda:

Metoda e prokurimit
a) Blerje

C. METODA TË VEÇANTA TË PROKURIMIT TË SHËRBIMEVE TË KONSULENTËVE

1. Përzgjedhja e bazuar në cilësi dhe kosto. Përveç kur parashikohet ndryshe në paragrafin 2 më poshtë, shërbimet e konsulentëve prokurohen sipas kontratave të dhëna mbi bazën e përzgjedhjes të bazuar në cilësi dhe kosto.

2. Metoda të tjera të prokurimit të shërbimeve të konsulentëve. Tabela e mëposhtme përcakton metodat e prokurimit, përveç përzgjedhjes të bazuar në cilësi dhe kosto, që mund të përdoren për shërbimet e konsulentëve. Plani i prokurimit përcakton rrethanat sipas të cilave mund të përdoren këto metoda.



Metoda e prokurimit
a) Përzgjedhja e bazuar në cilësi
b) Përzgjedhja e kostos më të ulët
c) Përzgjedhja e burimit të vetëm të firmave konsulente
d) Përzgjedhja e bazuar në kualifikimet e konsulentëve
e) Procedurat e përcaktuara në paragrafët 5.2 dhe 5.3 të udhëzimeve të konsulentëve për përzgjedhjen e konsulentëve individualë

D. RISHIKIMI NGA BANKA I VENDIMEVE TË PROKURIMIT

Të gjitha kontratat u nënshtrohen rishikimit paraprak të bankës.

SEKSIONI IV TËRHEQJA E TË ARDHURAVE TË HUAS

A. TË PËRGJITHSHME

1. Huamarrësi mund të tërheqë të ardhurat e huas në përputhje me dispozitat e nenit 2 të kushteve të përgjithshme, këtë seksion dhe udhëzimet shpesh që banka përcakton me njoftim për huamarrësin (duke përfshirë “Udhëzimet e disbursimit të Bankës Botërore për projektet” të muajit maj 2006, të cilat rishikohen herë pas here nga Banka dhe që bëhen të zbatueshme për këtë marrëveshje sipas këtyre udhëzimeve), për financimin e shpenzimeve të pranueshme, të përcaktuara në tabelën në paragrafin 2 më poshtë.

2. Tabela e mëposhtme përcakton kategoritë e shpenzimeve të pranueshme që mund të financohen nga të ardhurat e huas (kategoria), alokimin e shumave të huas për secilën kategori dhe përqindjen e shpenzimeve që duhet të financohen për shpenzimet e pranueshme në çdo kategori. Taksat nuk janë të pranueshme për financimin e të ardhurave të huas.

Kategoria	Shuma e huas së alokuar (shprehur në euro)	Përqindja e shpenzimeve që duhet të financohen
1) Mallrat dhe punimet	15,000,000	100%
2) Shërbimet e konsulentëve për zhvillimin hidroenergjetik dhe menaxhimin e ujit për pjesët 2.1 dhe 2.4 të projektit	0	100%
3) Tarifa fillestare	38,750	Shuma e pagueshme sipas Seksionit 2.03 të kësaj marrëveshjeje, në përputhje me seksionin 2.07 (b) të kushteve të përgjithshme
4) Të paalokuara	461,250	
Shuma totale	15,500,000	

Për qëllime të këtij skeduli, termi “shërbimet e konsulentëve për zhvillimin hidroenergjetik dhe menaxhimin e ujit” nënkupton shpenzimet për shërbimet e konsulentëve për studimet, studimet e fizibilitetit, planprojektin dhe mbikëqyrjen e ndërtimit.

B. KUSHTET E TËRHEQJES; PERIUDHA E TËRHEQJES

1. Pavarësisht nga dispozitat e pjesës A të këtij seksioni, nuk do të bëhet asnjë tërheqje për pagesat e kryera përpara datës së kësaj marrëveshjeje.

2. Data e përfundimit është 30 dhjetor 2016.

SKEDULI 3 SKEDULI I AMORTIZIMIT

1. Tabela e mëposhtme përcakton datat e pagesës së principalit të huas dhe përqindjen e shumës totale të principalit, të pagueshme në çdo datë të pagesës së principalit (pjesa e këstit). Nëse të ardhurat e huas janë tërhequr plotësisht deri në datën e parë të pagesës së principalit, shuma e principalit të huas e shlyeshme nga huamarrësi në çdo datë të pagesës së principalit, do të përcaktohet nga Banka duke shumëzuar: a) balancën e tërhequr të huas deri në datën e parë të pagesës së principalit; me b) pjesën e këstit për çdo datë të pagesës së principalit; kjo shumë e shlyeshme duhet të përshtatet, sipas nevojës, për të zbritur çdo shumë të përmendur në paragrafin 4 të këtij skeduli, për të cilin zbatohet një këmbim valutë.

Data e pagesës së principalit	Pjesa e këstit (shprehur në përqindje)
Çdo 15 maj dhe 15 nëntor Duke filluar nga data 15 maj 2018 deri në 15 nëntor 2028	4.35 %
Më 15 maj 2029	4.30 %

2. Nëse të ardhurat e huas nuk janë tërhequr plotësisht deri në datën e parë të pagimit të principalit, shuma e principalit të huas së shlyeshme nga huamarrësi në çdo datë të pagimit të principalit, do të përcaktohet si më poshtë:

a) Në masën që të ardhurat e huas janë tërhequr deri në datën e parë të pagesës së principalit, huamarrësi do të shlyejë balancën e tërhequr të huas deri në këtë datë, në përputhje me paragrafin 1 të këtij skeduli.

b) Çdo shumë e tërhequr pas datës së parë të pagesës së interesit, shlyhet në çdo datë të pagesës së principalit që bie pas datës së kësaj tërheqjeje në shumat e përcaktuara nga banka, duke shumëzuar shumën e çdo tërheqjeje të tillë me një fraksion, numëruesi i të cilit është pjesa fillestare e këstit të përcaktuar në tabelën, në paragrafin 1 të këtij skeduli për datën e lartpërmendur të pagesës së principalit (pjesa e këstit fillestar) dhe emërtuesi i të cilit është shuma e të gjitha pjesëve të mbetura të këstit fillestar për datat e pagesës së principalit që bien në ose pas kësaj date, ato shuma të shlyeshme duhet të përshtaten, sipas nevojës, për të zbritur shumat e përmendura në paragrafin 4 të këtij skeduli për të cilin zbatohet këmbimi i monedhës.

3. a) Shumat e huas së tërhequr brenda dy muajve kalendarike përpara çdo date të pagesës së principalit, për qëllime vetëm të llogaritjes së shumave të principalit, të pagueshme në çdo datë të pagesës së principalit, do të trajtohen si të tërhequra dhe të papaguara në datën e dytë të pagesës së principalit, pas datës së tërheqjes dhe do të jenë të shlyeshme në çdo datë të pagesës së principalit që fillon me datën e dytë të pagesës së principalit pas datës së tërheqjes;

b) Pavarësisht nga dispozitat e nënparagrafit (a) të këtij paragrafi, nëse në çdo kohë banka miraton një sistem faturimi në datën e kërkueshme sipas të cilit lëshohen fatura në ose pas datës përkatëse të pagimit të principalit, dispozitat e këtij nënparagrafi nuk zbatohen më për tërheqjet e bëra pas miratimit të këtij sistemi faturimi.

4. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij skeduli, pas një këmbimi të monedhës të të gjithë ose një pjesë të balancës së tërhequr të huas për një valutë të aprovuar, shuma e konvertuar në monedhën e aprovuar që është e shlyeshme në çdo datë të pagimit të shlyerjes që zhvillohet gjatë periudhës së konvertimit, përcaktohet nga banka duke shumëzuar këtë shumë në monedhën e saj të kuotimit menjëherë përpara konvertimit ose me: i) normën e këmbimit që reflekton shumat e principalit në monedhën e aprovuar, të pagueshme nga banka sipas transaksionit



mbi sigurimin e investimeve në lidhje me konvertimin; ose ii) nëse banka përcakton në përputhje me udhëzimet e konvertimit, komponentin e normës së këmbimit të normës për shlyerjen e interesit.

5. Nëse balanca e huas së tërhequr është shprehur në më shumë se një monedhë huaje, dispozitat e këtij skeduli zbatohen veçmas për shumën e shprehur në çdo monedhë huaje, në mënyrë që të planifikohet një skedul i veçantë amortizimi për çdo hua të tillë.

SHTOJCË

SEKSIONI I PËRKUFIZIMET

1. “Komiteti shqiptar i digave të mëdha” nënkupton komitetin e digave të mëdha të huamarrësit, të krijuar në bazë të ligjit nr. 8681 të datës 11 shkurt 2000 “Mbi mbrojtjen, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave të mëdha”, të ndryshuar.

2. “Udhëzimet antikorrupsion” nënkupton “udhëzimet për parandalimin dhe luftimin e mashtrimit dhe korrupsionit në projektet e financuara nga huatë e BERZH-it dhe kreditë dhe grandet e SHZHN-së”, të datës 15 tetor 2006 dhe të rishikuar në janar 2011.

3. “Kategori” nënkupton një kategori të përcaktuar në tabelën në seksionin 4 të skedulit 2 të kësaj marrëveshjeje.

4. “Bashkëfinancues” nënkupton bashkërisht Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe sekretarin e shtetit për çështjet ekonomike të Zvicrës. “Bashkëfinancues” nënkupton individualisht ndonjë prej bashkëfinancuesve.

5. “Bashkëfinancim” nënkupton, për qëllimet e paragrafit 16 të shtojcës së kushteve të përgjithshme, sa më poshtë: a) një shumë prej 12,700,000 eurosh që duhet të ofrohet nga Banka Europiane për rindërtim dhe zhvillim, për të ndihmuar në lidhje me financimin e projektit; dhe b) një shumë të barazvlefshme deri në 10 milionë US\$ që duhet të ofrohet nga sekretari i shtetit për çështjet ekonomike të Zvicrës, për të ndihmuar në lidhje me financimin e projektit.

6. “Marrëveshje bashkëfinancimi” nënkupton bashkërisht: a) marrëveshjen e bashkëfinancimit të BERZH-it që duhet të lidhet ndërmjet njësisë për zbatimin e projektit dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, që parashikon një shumë prej 12,700,000 eurosh, e cila duhet të ofrohet nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për të ndihmuar në lidhje me financimin e projektit; dhe b) Marrëveshjen e bashkëfinancimit SECO të datës 24 maj 2011, të lidhur ndërmjet huamarrësit dhe sekretarit të shtetit për çështjet ekonomike të Zvicrës, që parashikon një shumë të barasvlershme deri në 10 milionë US\$ që duhet të ofrohet nga Sekretari i Shtetit për Çështjet Ekonomike të Zvicrës, për të ndihmuar në lidhje me financimin e projektit.

7. “Udhëzimet e konsulentëve” nënkupton “udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore”, të publikuara nga banka në maj 2004 dhe të rishikuara në tetor 2006.

8. “Plan institucional i sigurisë së digave” nënkupton planin që duhet të miratohet nga njësia e zbatimit të projektit, i cili trajton çështje të sigurisë së digave në kaskadat e lumit Drin dhe Mat dhe mënyrat për rregullimin e tyre.

9. “Plan i gatishmërisë në raste emergjencash” nënkupton planin që duhet të përgatitet nga njësia e zbatimit të projektit, i pranueshëm për bankën, i cili përcakton rolet e palëve përgjegjëse kur mosfunksionimi i digës konsiderohet i afërt ose kur rrjedha e pritshme operationale rrezikon jetën, pronat ose operationet ekonomike në rrjedhën e poshtme, të cilat varen nga nivelet e rrjedhës së lumit.

10. “Plan i menaxhimit mjedisor” nënkupton planin e miratuar nga huamarrësi më 15 maj

2008, i pranueshëm për bankën, që përbëhet nga grupi i masave lehtësuese, monitoruese dhe institucionale, të cilat duhet të merren për të eliminuar ndikimet negative mjedisore dhe sociale, për t'i eliminuar ose zvogëluar në nivele të pranueshme, si dhe masat e nevojshme për realizimin e këtyre masave.

11. “Kushtet e përgjithshme” nënkupton “kushtet e përgjithshme të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për huatë” të datës 31 korrik 2010.

12. “Marrëveshje fillestare financimi” nënkupton marrëveshjen e financimit për projektin e sigurisë së digave ndërmjet huamarrësit dhe bankës të datës 2 korrik 2008, të ndryshuar, deri dhe duke përfshirë datën e kësaj marrëveshjeje (kredia nr. 4480).

13. “Projekt fillestar” nënkupton projektin e përshkruar në marrëveshjen fillestare të financimit.

14. “Panel ekspertësh” nënkupton panelin me të paktën 3 ekspertë në fusha të ndryshme teknike që lidhen me aspekte të sigurisë së digave të Fierzës, Komanit, Vaut të Dejës, Shkopetit dhe Ulzës, të krijuar në bazë të termave të referencës të pranueshëm për bankën dhe përgjegjës për rishikimin dhe udhëzimin e huamarrësit dhe njësisë për zbatimin e projektit mbi çështje të lidhura me sigurinë e digave dhe aspekte të tjera të rëndësishme të digave, strukturave të tyre përkatëse, zonave të ujëmbledhësve, zonave rreth rezervuarit dhe zonave në rrjedhën e poshtme.

15. “Udhëzimet e prokurimit” “udhëzimet: prokurimi sipas huave të IBRD-së dhe kredive të IDA-së” të publikuara nga banka në muajin maj 2004 dhe të rishikuara në tetor 2006.

16. “Plan prokurimi” nënkupton planin e prokurimit të huamarrësit për projektin, ë datës 19 tetor 2011 dhe të përmendur në paragrafin 1.18 të udhëzimeve të prokurimit dhe paragrafin 1.25 të udhëzimeve të konsulentëve, të cilat përditësohen herë pas here në përputhje me dispozitat e paragrafëve të mësipërm.

17 “Program” nënkupton programin e planifikuar për të mbështetur Komunitetin e Energjisë për Europën Juglindore, të përcaktuar në Traktatin e Komunitetit të Energjisë të datës 23 tetor 2005, nëpërmjet një serie huash të programit që mund të përshtaten për shtetet anëtare të Bankës në Europën Juglindore.

18. “Njësi për zbatimin e projektit” ose “NJZP” nënkupton Korporatën Energjetike Shqiptare, KESH, një shoqëri e pavarur e krijuar në bazë të legjislacionit të njësisë për zbatimin e projektit.

19. “Legjislacioni i njësisë për zbatimin e projektit” nënkupton ligjin e huamarrësit nr. 7926, datë 20 prill 1995, të ndryshuar.

20. “Njësi për menaxhimin e projektit” nënkupton njësinë e ngarkuar për menaxhimin e zbatimit të projektit, e krijuar pranë njësisë për zbatimin e projektit.

21. “Marrëveshje nënhuaje” nënkupton marrëveshjen e përmendur në seksionin 1.B të skedulit 2 të kësaj marrëveshjeje, sipas së cilës huamarrësi do të vërë të ardhurat e huas në dispozicion të njësisë për zbatimin e projektit.



LIGJ
Nr. 41/2012

**PËR AFATET DHE PROCEDURAT E MBYLLJES SË PROCESIT
TË KONTROLLIT FINANCIAR TË PERSONAVE JURIDIKË JOBANKARË QË
KANË MARRË HUA NGA PUBLIKU I GJERË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Grupi mbikëqyrës, i emëruar dhe që ka funksionuar në përputhje me ligjin nr. 8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, të ndryshuar, shpërndalet.

Neni 2

Grupi mbikëqyrës, brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, i dorëzon me procesverbal personit të emëruar nga Ministri i Financave arkivin dokumentar, si dhe asetet financiare e jofinanciare, të krijuara deri në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Financimi i kësaj veprimtarie me fondet e Buxhetit të Shtetit ndërpritet menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij ligji. Administratori zhvillon veprimtarinë duke përdorur asetet e shoqërive subjekt kontrolli.

Neni 3

Për administrimin e mëtejshëm të subjekteve të kontrollit, deri në likuidimin e plotë të tyre, Ministri i Financave emëron një administrator me një staf ndihmës, si dhe përcakton një limit buxhetor vjetor nga të ardhurat e subjekteve të kontrollit, për mbulimin e shpenzimeve të administrimit/likuidimit.

Neni 4

Administratori, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, duhet:

- a) t'i raportojë Ministrit të Financave gjendjen reale të pasurive të shoqërive, subjekte të kontrollit, nëpërmjet një raporti të hollësishëm, të shoqëruar me pasqyrat financiare të vitit më të fundit ushtrimor për secilën shoqëri nën administrim;
- b) të depozitojë në gjykatë kërkesat për faliment të të gjitha shoqërive, subjekte të kontrollit, të marra nën administrim;
- c) të përgatisë dokumentacionin për shitje të të gjitha aseteve të paluajtshme dhe ta dërgojë në Njësinë që merret me Administrimin dhe Shitjen e Pronave pranë Ministrisë së Financave.

Neni 5

Njësia që merret me Administrimin dhe Shitjen e Pronave merr në dorëzim, për shitje, dokumentacionin e të gjitha aseteve të paluajtshme të subjekteve, objekt i këtij ligji, dhe zhvillon procedurat e shitjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Të ardhurat nga shitja derdhen në llogaritë e subjekteve të kontrollit, të vëna në dispozicion nga administratori.

Neni 6

Administratori, në varësi të të ardhurave të siguruara nga shitja e aseteve të paluajtshme, si dhe nga arkëtimi i debitorëve, i propozon Ministrit të Financave koeficientin e ri të rishpërndarjes së detyrimeve për kreditorët. Koeficienti i rishpërndarjes, skema dhe radha e shpërndarjes miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit të Financave.

Neni 7

Në përfundim të afatit gjashtëmujor, të parashikuar në nenin 4 të këtij ligji, Ministri i Financave vendos për kohën dhe procedurat e mbylljes përfundimtare të procesit të administrimit të shoqërive, subjekt kontrolli, në përputhje me ecurinë e procesit të shitjes së aseteve, si dhe të proceseve gjyqësore me palë shoqëritë subjekt kontrolli.

Fondet që janë të depozituara në bankën e nivelit të dytë, e cila po realizon pagesat e kreditorëve të shoqërive, do të jenë në dispozicion të këtyre të fundit për një periudhë 5-vjeçare nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Pas këtij afati, të gjitha mjetet monetare të patërhequra do të depozitohen në një llogari të veçantë, të hapur nga Ministria e Financave, në një bankë të nivelit të dytë. Personat përfitues apo trashëgimtarët e ligjshëm të tyre mund të kërkojnë pranë Ministrisë së Financave kalimin në llogarinë e tyre personale të shumave takuese, përkundrejt paraqitjes së dokumentacionit që provon të drejtat e ligjshme të tyre. Kjo e drejtë përfundon dhe parashkruhet me kalimin e afatit prej 10 vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 8

Të gjitha proceset gjyqësore në ngarkim të debitorëve të shoqërive, subjekt kontrolli, do të vijojnë të ndiqen nga administratori, i cili do të kryejë edhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, deri në çastin që veprimtaria e tij do të vazhdojë. Me shpalljen të mbyllur të veprimtarisë së administratorit, ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë do të kryhet nga Ministria e Financave.

Neni 9

Ngarkohet Ministri i Financave të nxjerrë aktet nënligjore dhe udhëzimet në zbatim të këtij ligji.

Neni 10

Dispozitat e ligjit nr. 8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij, shfuqizohen për aq sa bien në kundërshtim me këtë ligj.



Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 12.4.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7412 datë 23.4.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 26.4.2012
Doli nga shtypi më 27.4.2012

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 34 lekë